


1. KANONIKU NE 25.08.2017
PËR ZANA BELLODI
XHEDLANE GJINI



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit -Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta-
Ministry of Culture, Youth & Sports

Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturor / Regionalni Centar za Kulturno Nasledje / Bölge
Kültürel Miras Merkezi / Regional Center for Cultural Heritage
Prizren

DATE/A:	24.08.2017
REFERENC-Ë:	Nr. 245/4
PËR/ZA/TO:	Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Samir Hoxha - Drejtor i QRTK-së Prizren
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendimi i Komisionit të IKMM-së Prishtinë

Po ju dërgojmë Vendimin e Komisionit të IKMM-së për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese-Konservuese të Trashëgimisë Kulturorë nr.73/2017 të dt. 07.08.2017 për lëndën Rexhep Morina Nr. 04-353/01-23716 për renovimin e brendshëm të objektit dhe ndërimin e kulmit, në ngastrën kadastrale Nr.3429-0 Z.K. Prizren.

Lëndës ia bashkangjesim kopjen e Vendimit.



REPUBLIC OF KOSOVO
INSTITUT ZA ZAŠTITU SPOMENIKA
438 21.08.2017

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /
Ministry of Culture, Youth and Sports

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve
Kosovo Institute for the Protection of Monuments
Institut Kosova za zaštitu spomenika

Nr. 73/2017
Datë: 07.08.2017

U.D. Drejtori i Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve z. Agim Gërguri duke u mbështetur në nenin 3 (paragrafi, 4, 8), nenin 4 (paragrafët 14, 17, 19 dhe 20) nenin 6 (paragrafët 3, 4, 5, 7 dhe 8), nenin 12 (paragrafi 2) të Ligjit Nr. 02/L – 88 për Trashëgiminë Kulturore, si dhe në zbatim të vendimit Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit Nr. 18/2016 të datës 04.03.2016, mori këtë:

VENDIM

1. Aprovohet rekomandimi i Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore të Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve: "Miratimi, me kushte si në arsyetim të këtij Vendimi, i projektit/kërkesës për dhënie e pëlqimit për renovimin e brendshëm dhe ndërrimin e kulmit të objektit afarist i cili gjendet në ngastrën kadastrale me Nr. 3429 – 0 Z.K. Prizren.
2. Në bazë të rekomandimit dhe arsytimit të Komisionit, kërkohet që gjatë zbatimit, të respektohet projekti zbatues i cili duhet të shqyrtohet dhe aprovohet në komision.
3. Zbatimi i punimeve sipas projektit të aprovuar bëhet nën mbikëqyrjen e zyrtarëve profesional nga Qendrat Rajonale për Trashëgimi Kulturore – Prizren.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Rexhep Morina nga Prizreni ka parashtruar kërkesë për dhënien e pëlqimit për renovim të brendshëm të objektit dhe ndërrimin e kulmit.

Objekti është një lokal afarist, me etazhitet B+P+1 dhe gjendet në rrugën "Vatra Shqiptare", në parcelën 3429 – 0 në Prizren. Sipas Planit të Konservimit dhe Zhvillimit për Zonën Historike të Prizrenit, parcela ku kërkohet të intervenohet gjendet në zonën e I – të. Me projekt parashihet suvatimi i fasadës, ndërrimi i dritareve dhe largimi i paneleve reklamuese.

Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore / IKMM, pas shqyrtimit të lëndës,

Rekomandon:

1. Të aprovohet projekti ideor për renovim të brendshëm të objektit dhe ndërrimin e kulmit të ndërtesës B+P+1 në parcelën 3429 – 0, me pronar Rexhep Morina me kusht që:

- 1.1. Kulmi të ketë pjerrtësi të njëjtë sikur kulmi ekzistues;
- 1.2. Dritaret e reja të punohen në bazë të karakteristikave të njëjta sikurse ato ekzistueset.
- 1.2. Të prezantohen në Projektin Kryesor, i cili duhet të sjellet në QRTK – Prizren, edhe detajet e dritareve ekzistuese me të gjitha karakteristikat e tyre duke përfshirë materialin, dimensionet, dhe prerjet e kornizave të dritareve.

2. Njoftohet pala se Projektin Kryesor, të Projektit Ideor të miratuar nga Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore / IKMM, duhet ta dorëzojë në QRTK-Prizren për verifikim (të gjitha kopjet e projektit që i nevojiten palës). Dy kopje dixhitale dhe dy kopje fizike të projektit kryesor mbeten në QRTK – Prizren (një për QRTK - në dhe një për IKMM-në).

Mbi bazën e këtij arsyetimi (rekomandimi të Komisionit) është vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi. Kushtet e vendosura në arsyetim konsiderohen në tërësi, obligative.

Vendimi i dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komisionit për Shqyrtimin e Kërkesave dhe Projekteve IKMM;
- Departamentit të Trashëgimisë Kulturore;
- QRTK – së përkatëse;
- Komunës përkatëse;
- Departamentit Ligjor – MKRS;
- Zyrës së Drejtorit të IKMM – së;
- Arkivit të IKMM – së;
- Arkivit të MKRS – së;

